



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT
PUBLIK**

**INSPEKTORATI I LARTË I
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT
TË INTERESAVE**

Nr. 7889 Prot. Dt 22.12.2021

Nr. 412 Prot. Dt 22.12.2021

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK, si organi i vetëm shtetëror rregullator për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë, i cili i ushtron kompetencat e tij, duke iu nënshtruar Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, përfaqësuar nga **Znj. Reida KASHTA**, Drejtori i Përgjithshëm, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si "palë",

DHE

INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE, si një institucion i pavarur me mision parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik, lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, si dhe parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, në garantim të interesit publik, përfaqësuar nga **Znj. Evgjëni BASHARI**, Inspektori i Përgjithshëm, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si "palë",

Duke vlerësuar se bashkëpunimi duhet të sigurojë pavarësinë dhe funksionimin e institucioneve në ushtrimin e kompetencave të tyre;

Me qëllim garantimin e një procesi prokurimi sa më eficient, ndërgjegjësimin e zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit publik, për vlerësim të pavarur dhe të pa ndikuar të ofertave dhe propozimeve të paraqitura;

Agjencia e Prokurimit Publik dhe Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi.

Neni 1

Baza ligjore

Palët në këtë Memorandum veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Administrative, ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”* i ndryshuar, ligjin nr. 60/2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, i ndryshuar, ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, ligjin nr. 125/2013 *“Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”*, i ndryshuar, ligjin nr. 36/2020 *“Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”* dhe ligjin nr. 9874/2008 *“Për ankandin publik”*, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 2

Qëllimi

Memorandumi ka si qëllim bashkëpunimin ndërmjet palëve në funksion të rritjes së integritetit të zyrtarëve në prokurimet publike dhe ndërgjegjësimin e tyre për zhvillimin e procedurave, në mënyrë të pavarur dhe të pa ndikuar nga interesat privatë.

Përcaktimet e këtij memorandumi nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore, mbi bazë dhe për zbatim të të cilave lidhet ky memorandum.

Neni 3

Angazhimet e palëve

Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi, në frymën e legjislacioneve respektive dhe, në mënyrë të veçantë:

- Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion për çështje të veçanta, për të cilat institucionet kanë interes të përbashkët, në respektim të ligjeve të posaçme të sipërcituara;
- Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke akte, literaturë juridike, tipologji, interpretime ligjore apo rregullatorë që kanë të bëjnë me fushën e prokurimeve dhe konfliktit të interesave;
- Të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta për përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni përkatës;
- Të organizojnë çdo formë tjetër të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve në funksion të përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 4

Detyrimet e palëve

- Agjencia e Prokurimit Publik do të kërkojë mendim të specializuar nga ILDKPKI, për çështje për të cilat, gjatë verifikimit të zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesioneve apo ankandit publik, apo monitorimit të zbatimit të kontratave, evidenton raste të dyshuara për konflikt interesi.

- Agjencia e Prokurimit Publik dhe ILDKPKI do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, për nxjerrjen e Njoftimeve apo hartimin e Manualeve Shpjeguese, të cilat i drejtohen autoriteteve kontraktore apo operatorëve ekonomikë, me qëllim evidentimin e rasteve për konflikt interesi, si dhe shmangien apo eliminimin e veprimeve që mund të kryejnë autoritetet kontraktore apo operatorët ekonomikë, gjatë zhvillimit të një procedure prokurimi, e cila çon në konflikt interesi.
- ILDKPKI angazhohet, që në përfundim të kontrolleve të deklaratave të interesave privatë të subjekteve që mbartin detyrim për deklarim, të ushtruar në zbatim të përcaktimeve ligjore dhe në rast të zbulimit të rasteve të konfliktit të interesit, në kryerjen e procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit apo ankandit publik të cilat janë objekt i punës së APP-së, t'i dërgojë kësaj të fundit një kopje të dokumentacionit të nevojshëm në një kohë sa më të shpejtë.
- ILDKPKI angazhohet, që në përfundim të kontrolleve të deklarimeve të iniciuara mbi bazën e informacionit të marrë nga APP, ta informojë këtë të fundit për rezultatet e kontrollit.
- Palët angazhohen të kërkojnë mendimet dhe sugjerimet e njëri – tjetrit, në rastet e nxjerrjes së rregulloreve, udhëzimeve apo amendimeve ligjore, që ndërlidhen me objektin e veprimtarisë së palës tjetër.

Neni 5 Komunikimi

Rregulli i përgjithshëm i shkëmbimit të informacionit është ai shkresor ose elektronik.

Palët, për zbatimin e kësaj marrëveshje, caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion, i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e këtij Memorandumi, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

Për Agjencinë e Prokurimit Publik, person i kontaktit do të jetë Znj. Xhoana Ristani, me këto kontakte:

Email: Xhoana.Ristani@app.gov.al

Për ILDKPKI, person i kontaktit do të jetë Znj. Mirela Gega, me këto kontakte:

Email: mgega@hidaa.gov.al

Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë, për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën, me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet mes palëve.

Neni 6
Ndryshime

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellë me shkrim të palëve.

Neni 7
Përfundimi i Memorandumit

1. Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga pala tjetër.
2. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

Neni 8
Dispozita të fundit

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve.
2. Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të varësisë me detyrimet e këtij Memorandumi, si dhe respektimin e zbatimit e detyrimeve që rrjedhin prej tij.
3. Për çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme, secila palë të informojë titullarin e institucionit.
4. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe dy në Autoritetin e Konkurrencës.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 22.12.2021

**AGJENCIA E PROKURIMIT
PUBLIK**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

REIDA KASHTA



**INSPEKTORATI I LARTË I
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT
TË INTERESAVE**

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

EMGJENI BASHARI

